



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:132193
Datë: 24.07.2023
Numri i dokumentit: 04533085

K. nr. 514/22

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm-Divizionit për Kundërvajtje, me Gjyqtarin individual Vesel Gorani, e me Zyrtaren Ligjore Teuta Berisha, në lëndën kundërvajtëse ndaj të pandehurit-ës **Milaim Zogu në cilësi të personit fizik të Operartorit Ekonomik NTP "AR&BENZ" me NUI:810210097 , njësia në Kamaran K.Glllogoc** , për veprën kundërvajtëse të paraparë me neni 13 të Ligjit nr. 08/L-018 , për tregtinë me produkte të Naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme , nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës , pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të seancave publike , e në bazë të neneve 55, 86, 124, dhe neni 127par.1dhe 2 të Ligjit për Kundërvajtje nr. 05/L-087 me datën 21.07.2023 mori:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI- Milaim Zogu i lindur me 01.03.1971 në Komoran , me nr. personal 1030225160 e me vendbanim në rr. "Bali Zogu" nr. 154 - Komoran K. Glllogoc ,në cilësi të personit fizik të Operartorit Ekonomik NTP "AR&BENZ" me NUI:810210097 , njësia në Kamaran K.Glllogoc .

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse me datën 13.06.2022, Inspektorët e Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë, në bashkëpunim me trupën Inspektuese “Sierra Lab” të autorizuar nga MINT (për vlerësimin e konformitetit të karburanteve të lëngëta të naftës) me datën e inspektimit 13.06.2022 janë marrë mostrat për derivate e lëngëta të naftës për Dizel dhe Benzin me qëllim të verifikimit të cilësisë në pikën shitëse me pakicë të Derivateve të Naftës dhe pas arritjes së raportit të testimit të cilësisë të datës 13.06.2022 ka rezultuar që derivati i testuar Dizel është JOKONFORM me parametrat e përcaktuar me Udhëzimin Administrativnr.01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës (parametri pika e ndezjes është 48°C , ndërsa vlera e lejuar minimale është 55°C).

Për të njëjtën Çështje me datën 15.06.2022 është njoftuar Operatori Ekonomik për rezultatin jo komfor , mirëpo i njëjti nuk ka bërë kërkesë për super analizë ne afat prej 03(tre) ditësh e duke u konsideruar se është pajtuar me rezultatin e parë .

- e me këtë i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 13 si dhe n. 19 par.8 nënpar. 8.3 të Ligjit nr. 08/L-018 , për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të ripërtërishme , si dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës, e në bazë të neneve 55, 86, 119 dhe 124 të Ligjit për Kundërvajtje, andaj:

D Ë N O H E T

Me gjobë në shumë prej 3500 (tremijë e pesëqind) € .

Gjobën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar që ta paguajnë në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në xhirollogarinë nr. **1000430070000518** e në të kundërtën do të aplikohet neni 30 pika 4 i Ligjit për Kundërvajtje e do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm .

Shpenzime të procedurës kundërvajtëse nuk ka pasur.

OBLIGOHET i pandehuri që në emër të paushallit Gjyqësor të paguaj shumën në larësi prej **10 € (dhjetë), te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.**

Me nga një kopje të këtij aktgjykimi njoftohen palët procedurale.

A r s y e t i m

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë –Departamenti i Inspektimit-Inspektorati i Tregut, me nr. të proto. 3912-19 të datës 21.06.2022 në Prishtinë, ka kërkuar që të zhvillohet procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit: Milaim Zogu në cilësi të personit fizik të Operatorit Ekonomik NTP "AR&BENZ" me NUI:810210097 , njësia në Kamaran K.Glllogoc , e cila kërkesë është pranuar në Gjykatë me datën 23.06.2022 për veprë kundërvajtëse të përshkruar në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata ka vepruar sipas kërkesës së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregut, duke vepruar sipas dispozitave ligjore për të filluar procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehurit andaj , gjendja faktike dhe reale është vërtetuar në seancën gjyqësore të mbajtur me datën 14.07.2023 ku i pandehuri në mbrojtjen e tij deklaroi se: unë kam qenë i informuar se tek Biznesi Individual „Ar-Benz” për inspektim siç është e shënuar edhe në kërkesë për fillim të procedurës ndaj meje gjegjësisht Operatorit Ekonomik kanë qenë inspektorët e tregut dhe të njëjtit kanë përpiluar procesverbalin ashtu siç janë të shënuara edhe në kërkesë andaj për të njëjtën çështje kam qenë i informuar edhe me raportin e testimi të cilësisë së karburantit Dizel për dt. 13.06.2022 .

Ndërsa po ashtu e pranoj edhe faktin se nuk kam kërkuar super analizë nga se nuk e kam parë të arsyeshme dhe për ne ka qenë i pranueshëm dhe i besueshëm raporti i testimi që është bërë me këtë datë. Mirëpo si përfundim i kësaj unë e pranoj fajësinë për lëshimet e bëra

me rastin e testimi të bërë i cili ka rezultuar ashtu siç është i shënuar në kërkesë për derivate të naftës. Mirëpo për kundër kësaj që unë jam për herë të parë për shkelje të tillë dhe është biznes individual familjar dhe nuk është bërë me dijeninë tonë, kërkoj nga Gjykata që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe të dënohem me një dënim më të ultë nga se jemi biznes individual dhe me të njëjtin biznes i mbajmë dy familje si dhe të punësuarit që janë në këtë biznes individual.

Unë jam i penduar për këtë që ka ndodhur duke llogaritur që e kemi një emër të biznesit të respektueshëm në rrethinën ku zhvillohet ky biznes dhe po ashtu premtoj se në të ardhmen do të jem më të kujdesshëm dhe që e njëjta çështje të mos përsëritet më.

Pas dëgjimit të deklaratës së të pandehurit, shqyrtimit të shkresave të lëndës veç e veç dhe administrimit të provave duke u bazuar edhe në procesverbalin e Inspektorit të Tregut me nr. serik 000145/22, 000150/22, 000152/22 të dt. 13.06.2022 dhe 15.06.2022, Kopjes së ARBK-së me nr. të biznesit 71270017 e me nr. fiskal 60168913 me llojin e biznesit – Biznes Individual Raportit të Inspektimit nga Trupa Inspektuese Sierra –LAB Sh.p.k. i datës 13.06.2022 me konstatimin Jo Konform me dispozitat rregullative dhe pohimit nga ana e të pandehurit për kundërvajtjen e kryer, Gjykata erdhi në përfundim dhe konstatoj se në rastin konkret ekzistojnë vetit dhe tiparet e veprës kundërvajtëse të kryer nga neni 13 të Ligjit nr. 08/L-018, për tregtinë me produkte të Naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme, nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës, Gjykata të pandehurin shpalli përgjegjës dhe dënoi **me gjobë në shumë prej 3500 (tremijë e pesëqind) €, si dhe Obligoj në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 10 € (dhjetë)**, e duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e dënimit, ku si rrethanë lehtësuese Gjykata pranoi faktin se i pandehuri e pohon kundërvajtjen e kryer e po ashtu i njëjti kundërvajtjen e tillë e ka të kryer për herë të parë e duke deklaruar se është i penduar me atë çfarë i ka ndodhur e duke premtuar se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe që e njëjta çështje të mos përsëritet më, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë faktin në bazë se në bazë të Raportit të trupit Inspektues ka rezultuar se cilësia e karburanteve të lëngëta të Naftës jokonform me parametrat e lejuar ligjor.

Andaj pas shqyrtimit të shkresave të lëndës veç e veç dhe administrimit të provave të siguruar nga vrojtimi i drejt për drejt i personave zyrtar-ushtuesit të kërkesës dhe me rastin e shqiptimit të ndëshkimit gjykata pati për bazë peshën e veprës së kryer, shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit e me bindje se me një ndëshkim të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit tek i pandehuri dhe rrethina e tij.

Me sa u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
Rexh-I-Nr. 514/22
Data: 21.07.2023

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është Ankesa në afat prej 8 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës Apelit- Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë e për mes kësaj Gjykate.

Republika e Kosovës
VENDIMI ËSHTË I EKZEKUTUESHËM
ODLUKA JE IZVRŠNA

Më dt. 22.08.2023 vit.
Data god.

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

3131

Gjyqtari
Veseli Gorani

Gjykata Themelore Prishtinë - Dega
Gllgoc

URDHËRPAGESË - DËFTESË PAGESE - PLATNI NALOG - PRIZNANICA

Të plotësohet nga gjykata - Popunjara sud Nr. fiskal / Fiskalni broj: 600365226

Emri dhe Mbiemri/
Ime i prezime

Milaim Hysen Zogu

Shuma
Iznos

3500.00 €

Komuna/ Opština

Gllgoc

Adresa
Adresa

Komoran

Shkronja
Slovima

Tre Mijë Pesë Qind Euro Zero
Cent

Numri i lëndës
Broj predmeta

K-nr.514/22

Vendi
Mesto

Gllgoc

Përshkrimi
Opis

Denim me gjobë

Data
Datum

14/08/2023

Arkëtari i gjykatës
Blagajnik suda

Mihrije Bytyqi

Vula e gjykatës
Peçat suda

Agjencioni i mbledhjes së të hyrave (Banka) duhet të shënojë: Emrin dhe Mbiemrin, Nr. e Lëndës, Vandin e Gjykatës, Shumën e paguar, dhe UNIREF-in. Të mos bëhet asnjë pagesë pa këto informata.
Të gjitha parat duhet të transferohen në llogarinë e të hyrave gjyqësore - Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Nr. 1000 4300 7000 0518 BK - BQK.

Agencia za prikupljanje prihoda (Banka) mora upisati: ime i prezime, broj predmeta, sedište suda, uplaćenu sumu, i UNIREF. Nijednu uplatu ne primati bez ovih informacija. Celokupan iznos treba preneti na žiro račun sudskih prihoda - Sudski savet Kosova.

Br. 1000 4300 7000 0518 BK - CBK.

Vetëm për bankën - Samo za banku

Emri i agjencionit për mbledhjen e të hyrave (Banka)
Naziv agencije za prikupljanje prihoda (Banka)

Vendi
Mesto

Data
Datum

14-08-23

Shuma
Iznos

3500 €

Shuma me shkronja
Iznos slovima



SG15B03123026219

Emri dhe mbiemri i
paguesit
Ime i prezime platiše

Nr. i letërnjoftimit/Adresa
Broj lične karte/Adresa

Emri i arkëtarit në bankë
Ime blagajnika u banci

Vula e bankës
Peçat banke



Vërejtje: Paga duhet të bëhet në bankë dhe një kopje e fletëpagese duhet të kthehet në gjykatë brenda dy ditëve të punës. Për Organizatat Buxhetore afati i kthimit të fletëpagesës në Gjykatë nga dita e pagesës është 5 ditë pune nga dita e pagesës.

Napomena : uplata mora biti izvršena u banci i kopiju priznanice se mora vratiti u roku od dva dana . Budžetske organizacije povratka rok od vaučera za plaćanje na sudu od dana uplate je 5 radnih dana od dana uplate .

4 Për Lëndën
Za Predmet

Gjykata Themelore Prishtinë - Dega
Gllgoc

URDHËRPAGESË - DËFTESË PAGESE - PLATNI NALOG - PRIZNANICA

Të plotësohet nga gjykata - Popunjara sud Nr. fiskal / Fiskalni broj: 600365226

Emri dhe Mbiemri/ Ime i prezime	Milaim Hysen Zogu	Shuma Iznos	10.00 €
Komuna/ Opština	Gllgoc Adresa Komoran	Shkronja Slovima	Dhjetë Euro Zero Cent
Numri i lëndës Broj predmeta	K-nr.514/22	Vendi Mesto	Gllgoc
Përshkrimi Opis	Paushall	Data Datum	14/08/2023
Arkëtar i gjykatës Blagajnik suda	Mihrije Bytyqi	Vula e gjykatës Peçat suda	
Nënshkrimi Potpis			

Agjencioni i mbledhjes së të hyrave (Banka) duhet të shënojë: Emrin dhe Mbiemrin, Nr. e Lëndës, Vending e Gjykatës, Shumën e paguar, dhe UNIREF-in. Të mos bëhet asnjë pagesë pa këto informata.

Të gjitha parat duhet të transferohen në llogarinë e të hyrave gjyqësore - Këshilli Gjyqësor i Kosovës.


Nr. 1000 4300 7000 0518 BK - BQK.

Agjencia za prikupljanje prihoda (Banka) mora upisati: ime i prezime, broj predmeta, sedište suda, uplaćenu sumu, i UNIREF. Nijednu uplatu ne primati bez ovih informacija. Celokupan iznos treba preneti na zero račun sudskih prihoda - Sudski savet Kosova.

Br. 1000 4300 7000 0518 BK - CBK.

Vetëm për bankën - Samo za banku

Emri i agjencionit për mbledhjen e të hyrave (Banka)	
Naziv agencije za prikupljanje prihoda (Banka)	
Vendi Mesto	
Shuma Iznos	
Shuma me shkronja Iznos slovima	
Emri dhe mbiemri i paguesit Ime i prezime platiše	
Nr. i letërnjoftimit/Adresa Broj lične karte/Adresa	
Emri i arkëtarit në bankë Ime blagajnika u banci	
Data Datum	14.08.23
Vula e bankës Peçat banke	



SG1AA0312302622S



Vërejtje: Paga duhet të bëhet në bankë dhe një kopje e fletëpagese duhet të kthehet në gjykatë brenda dy ditëve të punës. Për Organizatat Buxhetore afati i kthimit të fletëpagesës në Gjykatë nga dita e pagesës është 5 ditë pune nga dita e pagesës.

Napomena : uplata mora biti izvršena u banci i kopiju priznanice se mora vratiti u roku od dva dana . Budžetske organizacije povrata rok od vaučera za plaćanje na sudu od dana uplate je 5 radnih dana od dana uplate .

4 Për Lëndën
Za Predmet